

VENDIM
Nr. 149, datë 11.3.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 206, DATË 6.4.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘PËRFUNDIMI I PUNIMEVE TË
MBETURA DHE PLOTËSIMI ME RRUGË DYTËSORE, NYJA E MILOTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 206, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore, Nyja e Milotit’”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 16 659 775.50 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë) lekësh ...” zëvendësohet me “... 17 282 495.50 (shtatëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë) lekësh ...”;

b) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera shtesë, prej 622 720 (gjashtëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lezhë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Lezhë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA SHITESË E PRONARËVE, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILËVE SHPRONËSOHET ME VENDIMIN NR. 206, DATË 6.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘PËRFUNDIMI I PUNIMEVE TË MBETURA DHE PLOTËSIMI ME RRUGË DYTËSORE, NYJA E MILOTIT’”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Sipërfaqja që shpronësohet						Objekti që shpronësohet				Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji pasurisë	Tokë “truall”			Tokë “arë”			Banim		Soc.-ek.			
								Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Vlera lekë		
82	Kujtim Sinan Lule Lindita Besim	Baftjar Baftjar Baftjar Baftjar	Isufi Isufi Tuga Hidri Isufi	3441	5/15	3,200	Arë				2240	278	622,720					622,720	
	SHUMA TOTALE																	622,720	